

VENDIM
Nr. 18/2016

**PËR DËRGIMIN NË GJYKATËN KUSHTETUESE TË MOCIONIT TË NJË GRUPI
PREJ 1/10 E ANËTARËVE TË KUVENDIT TË GRUPIT PARLAMENTAR TË
PARTISË DEMOKRATIKE, ME OBJEKT “KONSTATIMI I MBARIMIT TË
MANDATIT TË DEPUTETIT, ZOTIT KOÇO KOKËDHIMA, DHE DËRGIMIN E
ÇËSHTJES NË GJYKATËN KUSHTETUESE PËR KONSTATIMIN E
PAPAJTUESHMËRISË ME MANDATIN E DEPUTETIT”**

Në mbështetje të neneve 70, pikat 3 dhe 4, e 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, dhe në zbatim të vendimit nr. 7/2016 të Gjykatës Kushtetuese,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dërgimin në Gjykatën Kushtetuese, bazuar në nenin 70, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës, të mocionit të një grupi prej 1/10 e anëtarëve të Kuvendit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike me objekt “Konstatimi i mbarimit të mandatit të deputetit, zotit Koço Kokëdhima, dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për konstatimin e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 10.3.2016